



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 34P6 Prot

Tiranë, më 10/082020

U D H Ë Z I M

Nr. 7, datë 10.06.2020

“MBI MODALITETET PËR TRANSFERIMIN E ZËVENDËSNOTERIT ”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 15, pika 6, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”,

UDHËZOJ:

1. Zëvendësnoteri ka të drejtë transferohet pranë një noteri tjetër për të asistuar në ushtrimin e veprimtarisë noteriale në rastet e mbylljes së zyrës noteriale pranë së cilës zëvendësnoteri ushtron funksionin, si dhe mosplotësimin të vendit vakant të noterit, sipas procedurës dhe rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim.
2. Për qëllimet e këtij udhëzimi, konsiderohet që zyra noteriale është mbyllur në rastet e mëposhtme:
 - a) noteri ka ndërruar jetë;
 - b) noteri ka pezulluar veprimtarinë me kërkesë të tij sipas nenit 18 të ligjit për noterinë;
 - c) ndaj noterit është dhënë masa disiplinore e pezullimit nga detyra për një periudhë nga një deri në pesë vjet;
 - ç) ndaj noterit është dhënë masa disiplinore heqje përfundimtare e licencës për ushtrimin e profesionit të noterit.


- Drejtësisë të kërkesës për shprehje interesi nga noterët për t'u asistuar nga zëvendësnoter. Kërkesa qendron e publikuar në faqen zyrtare jo më pak se 30 ditë, si dhe i dërgohet për dijëni të gjithë noterëve që ushtrojnë veprimtarinë noteriale në të njëjtin rreth gjyqësor në të cilën ushtronte veprimtarinë noteriale zyra noteriale e mbyllur.
4. Me depozitim të shprehjeve të interesit nga noterët, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë i kërkon zëvendësnoterit të japë pëlqimin për t'u transferuar pranë noterit që ndodhet në të njëjtën bashki ose, kur kjo nuk është e mundur, në të njëjtin rreth gjyqësor si edhe zyra noterial e mbyllur. Në rastin kur nuk ka asnjë shprehje interesi nga noterët e të njëjtës bashki ose të njëjtit rreth gjyqësor, me kërkesën e noterit të interesuar, zëvendësnoteri mund të japë pëlqimin për t'u transferuar edhe pranë një noteri në një rreth gjyqësor tjetër.
 5. Zëvendësnoteri jep pëlqimin për t'u transferuar sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, jo më vonë se 10 ditë nga data e marrjes së kërkesës.
 6. Në rastet kur asnjë noter nuk ka depozituar shprehjen e interesit për transferimin e zëvendësnoterit, sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, Ministri i Drejtësisë, mund t'i kërkojë një noteri të të njëjtit rreth gjyqësor ose të një rrethi tjetër, të japë pëlqimin për transferimin e zëvendësnoterit.
 7. Ministri i Drejtësisë i kërkon pëlqimin për transferimin e zëvendësnoterit, noterëve që përmbushin kriteret e përgjithshme për krijimin e vendit të zëvendësnoterit sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Noterisë, si dhe nuk asistohen nga një zëvendësnoter.
 8. Noteri jep pëlqimin për transferimin e zëvendësnoterit jo më vonë se 10 ditë nga data e marrjes së kërkesës së Ministrit të Drejtësisë. Në këtë rast, transferimi vendoset pa pëlqimin e zëvendësnoterit.
 9. Transferimi i zëvendësnoterit kryhet me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë. Zëvendësnoteri lidh kontratën e punës jo më vonë se 10 ditë nga data e miratimit të urdhrimit për transferimin e tij.
 10. Në rast se asnjë nga noterët nuk shpreh interesin për transferimin e zëvendësnoterit ose nuk jep pëlqimin për t'u transferuar, si edhe në rastet kur zëvendësnoteri nuk lidh kontratën e punës brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij udhëzimi, zëvendësnoteri vendoset në listën e pritjes të krijuar sipas pikës 4 të nenit 9 të ligjit për noterinë.
 11. Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, pasqyron në regjistrin e zëvendësnoterëve transferimin e zëvendësnoterit.

12. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, noterët dhe zëvendësnoterët.

13. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI



ETILDA GJONAJ (SALIU)